

VENDIM
Nr. 884, datë 16.12.2016

**PËR SHPËRBLIMIN DHE KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR
FESTAT E FUNDVITIT, 2016**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë kompensohen financiarisht, për vitin 2016, në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

- a) Familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;
- b) Familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar;
- c) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
- ç) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.

2. Efektet financiare prej 439 000 000 (katërqind e tridhjetë e nëntë milionë) lekësh, përballohen nga buxheti i vitit 2016, zëri “Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë”, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama